



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-155

Prishtinë, më 28 prill 2014, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 28 PRILL 2014

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletiq dhe Albert Kinolli, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga Zyra e Presidentit: Amir Haradinaj,

Nga OSBE-ja: Floriana Shala dhe

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 14 dhe 18 prill 2014,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 14 dhe 18 prill 2014

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 14 dhe 18 prill 2014.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare të mbahet më 5 maj 2014, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Miratimi i amendamenteve në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të propozuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kontrollin e duhanit,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për masat antidamping dhe masat kundërbalancuese,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Skemat pensionale të financuara nga shteti,
8. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Aviacionin Civil,
9. Shqyrtimi i raportit vjetor për vitin 2013 i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës,

10. Shqyrtimi i raportit të Zyrës Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina për vitin 2013,
11. Shqyrtimi i raportit të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2013,
12. Emërimi i një anëtari në Bordin Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës,
13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me Forcat e Armatosura të Kosovës,
14. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media.

* * *

Kryetari i Kuvendit i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit se Qeveria e Republikës së Kosovës e ka proceduar në Kuvend Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me Forcat e Armatosura të Kosovës.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e Projektligjit të lartpërmendur, vendosi që atë ta radhisë në rend dite të mbledhjes plenare më 5 maj 2014, për shqyrtimin e të cilit duhet të vendosë seanca me shmangie nga Rregullorja e Kuvendit.

3. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave

1. Procedimi i nismës qytetare për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë

Kryesia, pas diskutimit lidhur me pikën e lartpërmendur, nxori këtë:

P ë r f u n d i m

Kërkohej nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqet mendim lidhur me nismën qytetare për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, si dhe të përgatisë deklaratën e ndikimit buxhetor dhe deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së së këtij projektligji në afatin prej një muaji nga dita e pranimit.

2. Procedimi i Projektligjit për lojërat e fatit

Kryesia, pas diskutimit lidhur me projektligjin e lartpërmendur, nxori këtë:

P ë r f u n d i m

1. Projektligji për lojërat e fatit, i propozuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, t'u shpërndahet deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa si Komision Funkcional që ta shqyrtojë projektligjin në parim dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime, para shqyrtimit të parë në seancë plenare.

3. Rekomandimi i Komisionit për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione lidhur me peticionin e qytetarëve të komunës së Rahovecit për ndriçimin e fatit të Ukshin Hotit

Kryesia u njoftua me rekomandimin e lartpërmendur dhe konstatoi që kjo pikë mund të radhitet në rend dite në njëren nga seancat plenare të radhës.

4. Propozimi për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Medie

Kryesia pas diskutimit, propozimin e lartpërmendur e radhiti në rend të ditës për mbledhjen plenare të radhës dhe nxori këtë:

P e r f u n d i m

1. Kërkohej nga grupet parlamentare të Kuvendit që deri në seancën e radhës më 5 maj 2014 t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media.

2. Përbërja e Komisionit ad hoc duhet të jetë si në vijim: GP i PDK-së, 2 anëtarë; GP i LDK-së, 2 anëtarë; GP VV, 1 anëtar; GP i AAK-së, 1 anëtar; GP i KKR-së, 1 anëtar; GP i SLS, 1 anëtar dhe GP "6+", 1 anëtar.

5. Informata e Agjencisë Kosovare të Privatizimit lidhur me ekzekutimin e vendimit të Kuvendit të Kosovës për pagat e punëtorëve të Fabrikës së Gypave në Ferizaj sipas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës

Kryetari i Kuvendit i njoftoi anëtarët e Kryesisë se Kuvendi i Republikës së Kosovës më 20 mars 2014 ka kërkuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës që t'i ndërmarrë veprimet e nevojshme për propozimin e kandidatit për anëtar të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit nga radha e ndërkombëtarëve, gjë të cilën ajo nuk e ka bërë, prandaj si pasojë bordi i kësaj agjencie ka mbetur jofunksional dhe pa kuorum.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale